



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 205, datë 30.09.2020

**PËR SHPALLJEN E VENDEVE TË LIRA PËR KANDIDATËT PËR
PROKUROR**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenet 35 pika 3 dhe 39 pika 1 të Ligjit Nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1 gërma b të Ligjit 115 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë" i ndryshuar, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë si vende të lira për emërimin e magistratëve të profilit prokuror, të diplomuar në vitin akademik 2019 — 2020, vendet e mëposhtme:
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës - 2 vende;
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec - 1 vend;
2. Të ftojë magistratët e profilit prokuror të diplomuar në vitin akademik 2019 — 2020 të paraqesin një kërkesë me shkrim ku të tregojnë parapëlqimin e tyre për vendet të përmendura në pikën e parë të këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

